

Neni 11

(Ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.03.1996)

(Ndryshuar me ligjin nr.9125, date 29.07.2003)

- 1) Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës rregullohen në mënyrë përparësie nga këto burime:
 - a. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
 - b. Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë
 - c. Ky Kod dhe aktet e tij nënligjore
 - d. Kontrata kolektive e punës
 - e. Kontrata individuale e punës
 - f. Rregullorja e brendshme
 - g. Zakonet lokale dhe profesionale.
- 2) Aktet nënligjore dalin në plotësim dhe zbatim të dispozitave të parashikuara nga ky Kod.

Ato mund të përcaktojnë kushte pune më pak të favorshme për punëmarrësit sesa ato të parashikuara nga ky Kod vetëm kur kjo parashikohet shprehimisht në këtë të fundit.
- 3) Çdo dispozitë që shkel një dispozitë të një shkalle më të lartë, është e pavlefshme.

Megjithatë, janë të vlefshme, vetëm ato dispozita që përmirësojnë pozitën e punëmarrësit.
- 4) Punëmarrësi nuk mund të heqë dorë nga të drejtat, që rrjedhin nga dispozitat urdhëruese të këtij Kodi ose të kontratave kolektive të punës. Janë të vlefshme marrëveshjet e bëra në prani të inspektorit të punës ose në formën e parashikuar në kontratën kolektive të punës, që kanë si qëllim të mënjanojnë me pajtim një konflikt, duke bërë lëshime të dyanshme, të pranuar me vullnet të lirë nga të dyja palët.
- 5) Zakonet profesionale zbatohen vetëm kur mungojnë dispozitat ligjore, parashikimet në marrëveshje, kontratë, si dhe kur dispozitat ligjore i referohen shprehimisht zakoneve profesionale.